



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA
KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË/ OPŠTINSKI SUD
U MITROVICU/ MUNICIPAL COURT IN MITROVICA



2

C.nr.61/12

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Gjykatës Komunale në Vushtrri), e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen **Elheme Peci** në çështjen juridike të paditëses: **rruga nr. 100, tё cilën e përfaqëson kundër tё paditurës: Ministria e Punëve të Brendshme** tё cilën e përfaqëson baza e kontestit: Anulim i Vendimit mbi Ndërprerjen e Marrëdhënieς së Punës, pas mbajtjes së seancës kryesore tё datës: 20.11.2012 me datën 10.12.2012 merr këtë::

A K T G J Y K I M

- **ANULOHEN:** Vendimi i Ministrit tё Punëve tё Brendshme i datës: 22.12.2010 më tё cilin është Hedhur poshtë si e pabazuar ankesa e paditëses dhe Vendimi i Drejtorisë tё Përgjithshëm tё Policisë së Kosovës i datës 17.11.2010 me tё cilin i është ndërprerë marrëdhënia e punës paditëses si tё **KUNDËRLIGJSHME**
- **OBLIGOHET** e Paditura- Ministria e Punëve tё Brendshme t'a kthej paditësen në punë në pozitën e njëjtë apo tё ngjashme që i përgjigjet kualifikimeve dhe aftësive profesionale me tё gjitha tё drejtat nga marrëdhënia e punës, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- **OBLIGOHET** e Paditura Ministria e Punëve tё Brendshme që t'ia paguaj paditëses në emër tё shpenzimeve procedurale shumën prej 338 euro, ndërsa gjykatës në emër tё shpenzimeve gjyqësore shumën prej 50 euro tё gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenimin e përmbarimit tё detyrueshëm,

A r s y e t i m

Paditësja me anë tё padisë së datës 26.03.2012 ka kërkuar anulimin e vendimeve tё Ministrisë së Punëve tё Brendshme si palë e paditur me tё cilat i është ndërprerë marrëdhënia e punës, si dhe ka kërkuar pagesën e tё gjitha pagave që nga koha kur është larguar nga puna deri me kthimin e tё njëjtës në punë sì dhe kompensimet e procedurës kontestimore:

E paditura në seancën përgatitore të datës 09.10.2012 deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të dërguar në gjykatë në fakt kjo përgjigje asnjëherë nuk arriti në gjykatë, e kontestoi padinë e paditëses, madje padinë e paditëses e konsideroi si të palejuar sepse është paraqitur pas afatit ligjor, gjithmonë duke u thirrur në atë se vendimi i Ministrit të Punëve të Brendshme është marrë me datë 22.12.2010 ndërsa padia është bërë me datë: 26.03.2012.

Në këtë pikë reagoi i autorizuari i paditëses i cili deklaroi se padia është e afatshme pasi vendimin e Ministrit paditësja e ka pranuar me datë: 07.03.2012.

Gjykata me këtë rast në këtë seancë mori aktvendim me të cilin e obligoi palën e paditur që brenda afatit 7 ditor t'ia prezantoi gjykatës provën me anë të së cilës do të mund të vërtetohej se vendimi i Ministrit paditës i është dorëzuar me datën që i referohet përfaqësuesja e të paditurës, meqenëse këtë e konsideroi si çështje paraprake në këtë çështje.

E paditura nuk e dorëzoi në gjykatë provën me të cilën gjykata e obligoi, por të njëjtën nuk ishte në gjendje ta prezantoi as në seancën kryesore, ndërsa gjykata si datë të dorëzimit të vendimit të Ministrit palës paditëse e mori datën 07.03.2012, me çka konsideroi se padia është e afatshme.

Në seancën kryesore i autorizuari i paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së bërë, konsideroi se në rastin konkret në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditëses janë shkelur procedurat e iniciimit dhe përfundimit të procedurës disiplinore, aq më parë kur paditëses i është mundësuar kthimi në punë dhe e njëjta ka vazhduar punën 28 muaj dhe vëtëm pas kalimit të kësaj kohe e njëjta njoftohet se i ndërprehet marrëdhënia e punës. I autorizuari i paditëses në seancë kryesore i propozoi gjykatës që paditësen ta dëgjoi në cilësi të palës.

Paditësja deklaroi se e përkrah në tërësi fjalën e të autorizuarit të saj dhe se nuk ka çfarë të shtoi.

Përfaqësuesi i të paditurës në këtë seancë deklaroi se e kundërshton në tërësi padinë dje kërkesëpadinë si të pabazuar. Ndërsa ndër të tjera deklaroi se paditësja në mënyrë vullnetare e ka ndërprerë marrëdhënien e punës duke u bazuar në parimet e Policisë.

Gjykata në procedurën e provave administroi këto prova: Deklaratën e paditëses në cilësi të palës e të njëjtës datë sikurse seanca kryesore, vendimi i drejtorit të përgjithshëm të policisë së Kosovës i datës: 17.11.2010, ankesa e paditëses e datës: 08.12.2010 kundër vendimit të drejtorit, vendimi i Ministrit të Punëve të Brendshme i datës: 22.12.2010 më vërejtje se pala paditëse të njëtin e ka pranuar me datë: 07.03.2012, urdhëresa për ekzekutimin e vendimit disiplinor e datës: 02.03.2012, memorandumi zyrtar mbi pranim-dorëzimin e armës datës: 09.11.2009, fleta për akuzë përpiluar nga inspektorati policor i Kosovës i datës: 08.09.2009, rekomandimi i Komisionit për Emërimë të Larta dhe Disiplinë në Polici i datës: 21.12.2009, raporti i oficerit Shyqri Selimi i datës: 06.07.2009.

Gjykata provat e administruara më lartë i vlerësoi një nga një dhe në report me njëra tjetër konform nenit 7 dhe 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Është jo kontestuese paditësja ka qenë në pushim vjetor nga data 01.05.2009-29.06.2009 duke përfshirë edhe pushimet e festave dhe ditët tjera të lira.

Paditësja ka qenë dashur që të lajmërohet në punë me datë: 30.06.2009.

Është jo kontestuese se vëllau i paditëses me datë: 30.06.2009 datë kur paditësja ka qenë e obliguar të filloj punën pas pushimit, është lajmëruar në Drejtorinë Rajonale të Policisë ne , për të njoftuar se paditësja gjegjësisht motra e tij më nuk do të kthehet në punë, sepse e njëjta është martuar dhe gjendet në ndërsa ky i fundit i ka dorëzuar pajisjet policore të paditëses.

Eshtë jo shumë e qartë pse ka filluar procedura disiplinore për mungesë pa arsyé për paditësen kur e njëjtë në ditën e parë të punës që eshtë dashur të paraqitet i ka njoftuar eprorët e saj më konkretisht Drejtorinë Rajonale se më nuk kthehet në punë, ndërsa kjo paraqet dorëheqje vullnetare gjë që e njëjtë pranohet edhe nga përfaqësuesi i të paditurës në seancë kryesore.

Përkundër faktit se e paditura ka qenë e njoftuar se paditësja më nuk do të kthehet në punë, ata iniciojnë procedurën disiplinore për mungesë pa arsyé nga puna për shkelje të rendë disiplinore nga neni 46 i Ligjit për Policinë, si dhe nga neni 6.7 të Udhëzimit Administrativ 15/2008 për llojet e shkeljeve të Rënda dhe të Lehta Disiplinore.

Të paditurës me datë 09.11.2009 i eshtë kthyer arma mbrapa pas aplikimit të së njëjtës për tu kthyer dhe i eshtë mundësuar të kthehet në punë.

Sipas Ligjit për Policinë neni 65.1 Zyrtarit policor i cili jep dorëheqje nga Policia me qëndrim të mirë mund ti mundësohet ripunësimi në Polici pa konkurs, nëse ka ndonjë pozitë të lirë për të cilën eshtë i kualifikuar.

E paditura e ka zbatuar një procedurë të tillë ndaj paditëses, por se në të njëjtën kohë procedurën disiplinore nuk e ka pushuar, gjë që në të njëjtën kohë paditësja eshtë hetuar për shkelje disiplinore edhe pse e njëjtë ka dhënë dorëheqje. Aty ku ka dorëheqje nuk ka shkelje, edhe nëse dorëheqja nuk ka mund të bëhet siç e kérkon ligji, e paditura një fakt të tillë e ka pranuar me veprime konkludente ngase i eshtë dhënë mundësia për kthim në punë dhe nuk ka sesi të konsiderohet ndryshe.

Secila procedurë çoftë ajo për kundërvajtje, administrative, penale por edhe ajo disiplinore eshtë procedurë e afatizuar pra eshtë e lidhur për një afati të caktuar, e tëra kjo në mënyrë që palët mos të mundën të abuzojnë me procedurën dhe me të drejtat e palëve kundërshtare, dhe se ky eshtë parim demokratik.

Sipas Udhëzimit Administrativ 10/2008 i cili tani eshtë i shfuqizuar por se në rastin konkret kur janë ndërmarrë veprimet ka qenë në fuqi në nenin 15 eshtë i paraparë afati 60 ditor kur çështja disiplinore duhet të përfundojë prej paraqitjes së kérkesës nga inspektorati Policor, ndërsa vetëm në rrethana të jashtëzakonshme ky afat mund të shtyhet edhe për 30 ditë.

Në rastin e paditëses procedura nga inspektorati policor ka filluar me datën: 08.09.2009 gjë që vërtetohet nga prova mbi fletën akuzuese të të njëjtës datë. Nga prova e Komisionit për Emërimë të Larta dhe Disiplinë në Polici vërtetohet se me datën 21.12.2009 Komisioni për Emërimë të Larta dhe Disiplinë në Polici nxjerr Rekomandimin për Ndërprerje të Marrëdhënies së Punës për paditësen dhe të njëjtën ia dërgon drejtorit të përgjithshëm të policisë. Tejkalimi i afatit eshtë bërë në këtë rast sepse Rekomandimi i KELDP-së vjen pas më shumë se 100 ditësh, do të thotë që eshtë gati dyfishi i 60 ditëshit (afatit të kérkuar). Kjo eshtë shkelje e nenit 15 të Udhëzimit Administrativ 10/2008. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës merret me datë: 17.11.2010 gati një vit pas rekomandimit të Komisionit përkatës për Emërimë të Larta dhe Disiplinë në Polici ndërsa kë qenë i obliguar që ky vendim të merret brenda afatit 30 ditor nga pranimi i rekomandimit të KELDP-së., gjë përbën edhe shkeljen tjetër të dytë në këtë procedurë.

Pas procedurë ankimore ndaj vendimit të Drejtorit dhe pas marjes së vendimit të Ministrit i njëjti vendim palës së akuzuar- paditëses duhet t'i dorëzohet vendimi brenda afatit 5 ditor nga nxjerra e vendimit. Ndërsa kjo gjë nuk ka ndodhë sepse Vendimin e Ministrit paditësja e ka pranuar me datën 07.03.2012 pas më shumë se 1 viti. E paditura me asnjë provë nuk arriti ta dëshmoj se më herët ia ka dorëzuar vendimin në fjalë dhe gjykata ia falë besimin palës paditëse. Dhe se në vendimin e Ministrit që e posedon paditësja shihet vula se i njëjti vendim në zyrën e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës eshtë pranuar me datë: 02.03.2012, ndërsa paditësja të njëjtin e ka pranuar me

datë 07.03.2012. Urdhëresa për ekzekutimin e vendimit disiplinor nxirret me datë 02.03.2012, ndërsa ekzekutimi efektiv është prej datës 09.03.2012.

Një procedurë mund të quhet kundërligjore nëse në ndonjë fazë të saj nuk përfillen afatet, apo shkelen të drejtat e palëve.

Gjykata vlerësoi se e paditura në lidhje me rastin në fjalë asnjëherë nuk ka pas asnjë vërejtje në punën e paditësesh ndërsa të njëjtës ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës në këtë mënyrë gjë që e sforcon edhe më tutje kundërligjshmërinë e vendimeve dhe procedurave të të paditurës.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se pretendimet e palës paditëse janë të vërteta dhe se kërkesëpadia e paditësesh është e bazuar, dhe se vendimet e të paditurës janë kundërligjore sepse nuk janë respektuar afatet, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori në bazë të nenit 452 të LPK-së dhe atë siç vijon: për padi 96 euro, dhe për dy përfaqësime: 242. euro., për aktgjykim shumën prej 50 euro.

Andaj, gjykata konform nenit 143, nenit 476 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË,
C.nr. 61/2012 me dt.10.12.2012

G J Y Q T A R I ,
Faton Ademi

UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë nëpërmjet kësaj gjykate.

E X P :

1. Paditesit
2. Të autorit paditent
3. Të paditentit

Alv.

11.12.2012